



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.24, datë 21. 04. 2021

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FËMIJËVE NË NEVOJË BARDHI
SINANAJ DHE VISTJANA SINANAJ**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 21.04.2021, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 23, pika 7, neni 54, Ligjit Nr. 9939, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe në VKB- në Nr. 68 datë 24.12.2020 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe buxhetit të vitit 2021 për Bashkinë Skrapar dhe institucionet ne varësi të saj"

VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës së menjëhershme financiare në masën 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për fëmijën Vistjana Sinanaj
2. Miratimin e ndihmës së menjëhershme financiare në masën 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për fëmijën Bardhi Sinanaj
3. Kjo ndihmë do të përballohet nga fondi i buxhetit të bashkisë, miratuar me VKB-në Nr. 68, datë 24.12.2020, duke bërë transferimin nga artikulli 602- 01110-05, në artikullin 606-01110-05, në vlerën 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 9- vota pro , vota kundër - s'ka, vota abstenim - 1 .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI